



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-005

Prishtinë, më 23 tetor 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 TETOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Aida Dërguti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerand Stavileci dhe Valmir Klaiqi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 20 dhe 28 shtator 2017.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të mërkurën, më 25 tetor 2017, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016.

* * *

Gjithashtu, Kryesia lidhur me pikën 4 të lartcekur të rendit të ditës, nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 25 tetor 2017, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së (kryetarin dhe 2 anëtarë), GP i LDK-së (2 anëtarë), GP i PDK-së (zëvendëskryetarin e parë dhe 1 anëtar), GP i Listës serbe (zëvendëskryetarin e dytë), GP i AAK-së (1 anëtar), GP i "Nismës për Kosovën" (1 anëtar) dhe GP "6+" (1 anëtar).

* * *

Kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca, e shtroi çështjen e rindarjes së zyrave dhe sallave për grupet parlamentare sipas fuqisë politike që ato kanë në Kuvend. Diskutimi i tij është dhënë i plotë në trasnkript.

Kryetari tha se lidhur me rindarjen e zyrave dhe të sallave për grupet parlamentare ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një propozim deri mërkurën, më 25. 10. 2017, mbi bazën e të cilit Kryesia e Kuvendit do të vendosë lidhur me këtë çështje.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Propozimi për shpalljen publike për një (1) anëtar në Bordin për Ankesa të Komisionit të Pavarur të Medieve

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se znj. Naile Selimaj-Krasniqi, kryeshefe ekzekutive e Komisionit të Pavarur të Medieve e ka informuar me shkrim Kuvendin se nga data 6 korrik 2017, Bordi i Ankesave nuk është në përbërje të plotë për shkak se një anëtare e këtij bordi ka ndërruar jetë.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë pikë, mori këtë:

V E N D I M

1. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa të Komisionit të Pavarur të Medieve.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve ta shpallë konkursin për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa të Komisionit të Pavarur të Medieve.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të Grave Deputete për vazhdimin e kontratës së asistentes së këtij grupi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Znj. Arjeta Rexhepi i vazhdohet kontrata e punës në pozitën e asistentes së Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar të deputetëve të Kuvendit në Bruksel

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Fitore Pacolli, Fidan Rekaliu, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Bekë Berisha dhe Bahri Shabani u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 19 - 22 nëntor 2017, ndërsa deputeti Fidan Rekaliu do të udhëtojë prej datës 20-22 nëntor 2017.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës, ndërsa nga Parlamenti Evropian do të rimbursohen shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për katër (4) deputetë.

4. Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar të deputetëve të Kuvendit në Bruksel

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Kryetarëve dhe përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Albulena Balaj-Halimaj dhe Adem Hoxha u lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej datës 19-22 nëntor 2017.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (me tejkallim në bazë të rezervimit paraprak) dhe të mëditjeve për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës, ndërsa nga Parlamenti Evropian do të rimbursohen shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për katër (4) kryetarë të grupeve parlamentare.

5. Njoftimi i kryetares së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, znj. Sala Berisha-Shala, lidhur me përbërjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Plenumin Parlamentar të Komunitetit të Energjisë

Kryesia u njoftua me shkrim nga kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal se ky komision i ka caktuar deputetët Sala Berisha-Shala dhe Dardan Sejdiu për anëtarë të përhershëm të Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, si dhe deputetët Gani Dreshaj dhe Hykmete Bajrami për zëvendës të tyre.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale